



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KRYETARI

V E N D I M

Nr. 449, datë 17 . 9 .2020

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË DETYRUAR VENDOR PËR ZONËN E RE PËR
ZHVILLIM NË FSHATIN VALIAS, NJËSIA ADMINISTRATIVE VALIAS”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, neni 9, pika 1/1, shkronja”b” dhe nenit 23, pika 14 e Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr. 97/2019 “Për miratimin e Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 887, datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e Planit të Detyruar Vendor, si dhe procedurës së miratimit të Lejeve të Zhvillimit/ Ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, të Vendimit Nr. 468, datë 10.06.2020 “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në fshatin Valias, Bashkia Kamzë, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese”, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar,

VENDOSA:

1. Miratimin e Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim, në fshatin Valias, Bashkia Kamzë në funksion të procesit të rindërtimit, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në aktet normative në fuqi, pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtëm:
 - a) Raporti i Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim;
 - b) Materiali hartografik:
 - i. Harta e Përdorimit të Tokës;
 - ii. Harta e Projektimit Urban;
 - iii. Harta e Infrastrukturës së Transportit;
 - iv. Skema e apartamenteve dhe banesave kolektive.
2. Miratohet rindërtimi në Zonë e Re për Zhvillim për Fazën I, sipas përcaktimeve të Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim, me qëllin rindërtimin e objekteve të cilat referuar aktekspertizës së thelluar dhe oponentit teknik nga Instituti i Ndërtimit janë shpallur me rrezikshmëri të lartë dhe për shembje të detyruar. Faza II e Planit të Detyruar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KRYETARI

Vendor për Zonën e Re për Zhvillim është orientuese për zhvillim e zonës, në rastet e paraqitjes së kërkesave për zhvillim e pronave nga sektori privat dhe pronaret.

3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për botimin e Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim, në fshatin Valias, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e miratimit të tij.
4. Plani i Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim, në fshatin Valias të integrohet me Planin e Përgjithshëm Vendor në fuqi, duke ndjekur përcaktimet e Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”*, të ndryshuar.
5. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi pas botimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

KRYETARI
RAKIP SULLI

